

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"ADRIATISKA STRANDEN" SH.P.K.

Kavaje, me 27.05.2025

Ortakët themelues:

- Z. Bekim Beck banues ne Suedi me nr. personal 780412-5271.
- Z. Clas Ryden banues ne Suedi me nr. personal 721001-3632.
- Z. Mergim Bunjaku banues ne Suedi me nr. personal 930303-2735.
- Z. Afrim Alija me shtetesi kosovare nr. personal 1006417058 dhe leje qendrimi shqiptare me ID H236100051.

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar), sot më datë 27.05.2025 harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare si më poshtë vijon:

NENI 1

Emri

1.1 Shoqëria tregtare mban emrin "ADRIATISKA STRANDEN" SH.P.K.

1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

NENI 2

Forma


2.1 Shoqëria tregtare "ADRIATISKA STRANDEN" SH.P.K. ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ADRIATISKA STRANDEN" SH.P.K. do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën: Kavaje, Lagjia nr. 2, rruga "Jurgen Trade", kati i pare, prane bankes "Credins", zona kadastrale nr. 8552, pasuria nr. 4/5-N5.

NENI 4



Objekti i Veprimtarisë

4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare si agjensi imobiliare në shitblerjen e pasurive të paluajtshme.

NENI 5

Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë "ADRIATISKA STRANDEN" SH.P.K. do të jetë me afat të pacaktuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

6.1 Shoqëria tregtare "ADRIATISKA STRANDEN" SH.P.K. mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

7.1 Ortakët nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë "ADRIATISKA STRANDEN" SH.P.K. dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat


8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "ADRIATISKA STRANDEN" SH.P.K. është 100.000 (njëqindmije) lekë.

8.2 Ortakët e shoqërisë janë:

- 1- Z. Bekim Beck është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 32% të kapitalit të shoqërisë ose në vlerë 32.000 lekë.
- 2- Z. Clas Ryden është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 30% të kapitalit të shoqërisë ose në vlerë 30.000 lekë.
- 3- Z. Mergim Bunjaku është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 30% të kapitalit të shoqërisë ose në vlerë 30.000 lekë.
- 4- Z. Afrim Alija është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 8% të kapitalit të shoqërisë ose në vlerë 8.000 lekë.

NENI 9

Organet e Shoqërisë



Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10

Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Ortakë e Shoqërisë. Afati i emërimit është 5 (Pese) vjet. Kompetencat e adminsitatorit përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë është **Z. Afrim Alija** atësia Sheremet, lindur ne Likoc, Kosove, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar me numër personal 1006417058 dhe me leje qendrimi shqiptar ID H23610005L.

Ky Akt Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore.

ORTAKËT E SHOQERISE

"ADRIATISKA STRANDEN" SH.P.K.

Bekim Beck



Clas Ryden



Mergim Bunjaku



Afrim Alija

